


ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2016-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinator për gjurmimin në Shkollën “Kolin Gjoka”: Dorina Gjergji

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)	6
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	8
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)	9
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)	10
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)	10
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	11
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)	11
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)	12
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)	12
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)	13
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022	15
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2016-2022)	16
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)	16
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)	17
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2016-2022) ..	18
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)	18
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)	19
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)	19
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2022)	21
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	23
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	24
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)	24
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)	25
Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2022)	25
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)	26
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)	28
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)	29
Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)	30
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)	31
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)	31

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	13
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)	14
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)	14
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)	20
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)	21
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2022)	22
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2022)	22
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	25
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)	27
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	28
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)	29
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)	30
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)	32

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2016-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	12
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	13
3.4 Niveli i pagave.....	15
3.5 Kushtet e punës	17
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	20
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	20
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	21
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	23
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	25
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	29
3.12 Planet për të ardhmen	32
4 Përfundime	33

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla “**Kolin Gjoka**”, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i

maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **shtatë brezave me të diplomuar** të shkollës “Kolin Gjoka”.

2. Të diplomuarit 2016-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në shkollën “Kolin Gjoka” u diplomuan 110 nxënës (shiko tabelën 1), 8 nxënës më pak sesa gjatë vitit 2020-2021.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	119	64	54%
2016-2017	80	66	83%
2017-2018	70	46	66%
2018-2019	62	55	89%
2019-2020	113	96	85%
2020-2021	118	116	98%
2021-2022	110	107	97%

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 107 nxënës ose 97% e të diplomuarve. Të disagreguar sipas gjinisë janë gjurmuar 53 meshkuj dhe 54 femra (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=107

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimin Hoteleri-Turizëm me 45% dhe më të ulët in ata të drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore me 9%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=107

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 75% (N=80) e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, dhe 25% (N=27) jashtë vendit (shiko figurën 2). Mesatarisht për vitet 2020-2021, 86% e të diplomuarve jetojnë në Shqipëri dhe 14% jetojnë jashtë vendit një vit pas diplomimit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 10 (dhjetë) jetojnë në Gjermani, 10 (dhjetë) të tjerë në Itali, 2 (dy) në Angli dhe 2 (dy) në Francë. Nga 1 (një) i diplomuar jeton në Belgjikë, Suedi dhe Kosovë.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 107 të anketuarish 50% (N=54) ishin të punësuar, 3% (N=3) ishin të vetëpunësuar, 21% (N=22) ishin student/kursant, 11% (N=12) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 15% (N=16) të diplomuar një vit pas diplomimit.

Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=107

Referuar figurës 5, në vitin 2022, 64% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2022 shënon një rritje të punësimit me 21 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 43%. Viti që ka shënuar shkallën më të ulët të punësimit ka qenë viti 2019 me vetëm 29% të të diplomuarve të punësuar.

Ndërkohë, 15% e të diplomuarve në vitin 2022, janë të papunë. Mesatarisht, për vitet 2016-2021, 34% e të diplomuarve kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit. Si rezultat, për vitin 2022 kemi një ulje të papunësisë me 19 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021.

Ndërkohë, 21% e të diplomuarve të vitit 2022 janë student/kursant. Mesatarisht, në vitet 2016-2021 22% e të diplomuarve kanë qenë student/kursant. Pra, kemi një ulje me 1 pikë përqindje të atyre që vijojnë studimet e mëtejshme për vitin 2022 në raport me mesataren e viteve 2016-2021.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=64); 2017 (N=66); 2018 (N=46); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2022, 50% e të diplomuarve janë të punësuar dhe 3% të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Vërehet një rritje me 19 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (31%) e punësimit në raport me vetëpunësimin. Ndërkohë, mesatarja e vetëpunësimit në vitet 2016-2021 ka qenë 9%. Si rezultat, kemi një ulje të vetëpunësimit me 6 pikë përqindje për vitin 2022.

Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=64); 2017 (N=66); 2018 (N=46); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107).

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 77% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 69% e të diplomuarve në TIK, 45% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 30% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të punësuar një vit pas diplomimit. Si rezultat, drejtimi me numrin më të lartë të të diplomuarve të punësuar një vit pas diplomimit është Hoteleri-Turizëm. Ndërkohë, 30% (N=3) e të diplomuarve në

Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 15% (N=3) e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 14% (N=4) e të diplomuarve në TIK dhe 13% (N=6) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë të papunë në vit pas diplomimit. Për më tepër, 40% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe po 40% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë student/kursant. Ndërkohë, 17% e të diplomuarve në TIK dhe 10% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë student/kursant. Vërehet se për degët Ekonomi-Biznes, TIK dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore numri i të diplomuarve që vijojnë studime të mëtejshme është më i madh sesa i atyre që janë pa punë. Raport ndryshon për të punësuarit në Hoteleri-Turizëm ku numri i papunëve është më i lartë sesa i studentëve/kursantëve.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EB (N=20); HT (N=48); TIK (N=29); SHSSH (N=10)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 44% e vajzave të diplomuara janë të punësuar, 28% studente/kursante dhe 28% të papuna. Ndërkohë, 85% e djemve të diplomuar janë të punësuar, 13% student/kursant dhe 2% të papunë.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=53); F (N=54)

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 57% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 43% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2016 deri në 2021 (shiko figurën 9), mesatarisht 37% e të diplomuarve pohuan se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 63% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Si rezultat, për vitin 2022 vërehet një përmirësim me 20 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se puna lidhet me fushën e arsimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=23); 2018 (N=18); 2019 (N=16); 2020 (N=56); 2021 (N=76); 2022 (N=69)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht (2020-2022), 28% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 72% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 21% e të diplomuarve në TIK janë të punësuar në profesion. Ndërkohë, askush nga të diplomuarit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore nuk është punësuar në profesion. Si rezultat, të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm pohojnë një lidhje më të madhe të punës me arsimin në raport me drejtimet e tjera të ofruara nga shkolla.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020:** N_{EB}=15; N_{HT}=23; N_{TIK}=18; **Baza 2021:** N_{EB}=17; N_{HT}=30; N_{TIK}=24; N_{SHSSH}=5; **Baza 2022:** N_{EB}=9; N_{HT}=37; N_{TIK}=20; N_{SHSSH}=3

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 62% (N=28) e të diplomuarve të gjinisë mashkullore punojnë në profesion, ndërsa 38% (N=17) nuk punojnë në profesion. Ndërkohë, 46% (N=11) e të diplomuarave të gjinisë femërore punojnë në profesion, ndërsa 54% (N=13) nuk punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=45); F (N=24)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin tre arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (38% në 2022, mesatarja (2018-2021) 47%), (ii) paga/kushtet më të mira të punës aktuale (28% në 2022, mesatarja (2018-2021) 29%), si dhe (iii) mungesa e dëshirës për të punuar në një punë që lidhet me studimet (28% në 2022, mesatarja (2018-2021) 6%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	70%	45%	27%	44%	38%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	9%	16%	28%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	10%	18%	5%	7%	3%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	10%	27%	50%	28%	28%
Tjetër	10%	9%	9%	5%	3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=10); 2019 (N=11); 2020 (N=22); 2021 (N=43); 2022 (N=29)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2022 tregojnë se njohuritë përdoren

“shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 52% e të gjurmuarve. Mesatarisht, 41% e të diplomuarve në vitet 2016-2021 kanë pohuar se i përdorin “shumë/jashtëzakonisht shumë” njohuritë e fituara në shkollë. Si rezultat, për vitin 2022 vërehet një rritje me 11 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se i përdorin “shumë/jashtëzakonisht shumë” njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës.

Ndërkohë, 10% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2016-2021 ka qenë 14%. Pra, kemi ndër vite një ulje me 4 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” për vitin 2022 është 28%. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2016-2021 ka qenë 21%. Pra, kemi një rritje me 7 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët pohojnë që i përdorin “disi” njohuritë e fituara në shkollë.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	15%	35%	5%	25%	20%
Të diplomuar në 2017	12%	30%	27%	24%	6%
Të diplomuar në 2018	13%	25%	25%	6%	31%
Të diplomuar në 2019	10%	14%	38%	24%	14%
Të diplomuar në 2020	21%	18%	9%	32%	20%
Të diplomuar në 2021	12%	34%	21%	13%	20%
Të diplomuar në 2022	10%	10%	28%	20%	32%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2016 (N=20); 2017 (N=33); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=56); 2021 (N=76); 2022 (N=69)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 47% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 35% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 28% e të diplomuarve në vitet 2016-2021 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve “shumë/jashtëzakonisht shumë” dhe 56% me “pak/aspak”.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	45%	10%	10%	20%	15%
Të diplomuar në 2017	24%	42%	15%	12%	6%
Të diplomuar në 2018	38%	25%	13%	19%	6%
Të diplomuar në 2019	24%	19%	33%	10%	14%
Të diplomuar në 2020	43%	7%	13%	21%	16%
Të diplomuar në 2021	45%	12%	12%	17%	14%
Të diplomuar në 2022	25%	10%	19%	25%	22%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2016 (N=20); 2017 (N=33); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=56); 2021 (N=76); 2022 (N=69)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 3% më pak se paga minimale, 19% paga minimale – 35,000 lekë, 19% në fashën 35,001 – 50,000 lekë, 20% në fashën 50,001 – 65,000 lekë, 16% në fashën 65,001 – 80,000 lekë dhe 23% paguhen më shumë se 80,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=66

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Për vitin 2022, 3% e të diplomuarve të gjurmuar marrin një pagë më të ulët se paga minimale, me një përmirësim me 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 ku 14% e të diplomuarve merrnin më pak se paga minimale. Ndërkohë, përqindja e të diplomuarve të gjurmuar që marrin një pagë më të ulët se 35.000 lekë është ulur me 24 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (43% mesatarja, 19% në 2022).

Nga ana tjetër, është ulur me 6 pikë përqindje mesatarja e të diplomuarve që marrin një pagë 35,001 - 50,000 lekë. (25% mesatarja 2016-2021, 19% në 2022). Ndërkohë, është rritur me 13 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë (7% mesatarja 2016-2021, 20% në 2022). Gjithashtu, është rritur me 12 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë (4% mesatarja, 16% në 2022).

Viti 2022, shënon edhe përqindjen më të lartë të të diplomuarve që marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë. Kështu, 23% e të diplomuarve në vitin 2022 marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë, ndërkohë mesatarisht nga viti 2016-2021, vetëm 8% e të diplomuarve të gjurmuar e kanë marrë këtë pagë.

Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=23); 2018 (N=16); 2019 (N=16); 2020 (N=56); 2021 (N=76); 2022 (N=69)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se vetëm 10% (N=2) e të diplomuarve në TIK marrin më pak se paga minimale. Ndërkohë, 67% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësor, 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 19% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 15% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë minimale – 35,000 lekë. Për më tepër, 33% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 25% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm marrin një pagë midis 35,001 – 50,000 lekë.

Ndërkohë, 20% e të diplomuarve në TIK dhe përkatësisht nga 20% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe Hoteleri-Turizëm marrin një pagë mes 50,001 – 65,000 lekë. Një pagë 65,001 – 80,000 lekë e marrin 22% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 10% e të diplomuarve në TIK. Më shumë se 80,001 lekë e marrin 33% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes 24% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 20% e të diplomuarve në TIK.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N_{EB}=9; N_{HT}=37; N_{TIK}=20; N_{SHSSH}=3

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), asnjë nga të diplomuarat e gjinisë femërore nuk merr një pagë më të ulët se paga minimale. Ndërkohë, vetëm dy (4%) nga të diplomuarit e gjinisë mashkullore marrin më pak se paga minimale. Një pagë deri në 35,000 lekë e marrin 9 nga 24 vajza (38%) dhe 4 nga 45 (9%) djem të diplomuar. Për më tepër, 29% e të diplomuarve të gjinisë femërore dhe 13% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore marrin 35,001 – 50,000 lekë. Një pagë mes 50,001 – 65,000 e marrin 25% e të diplomuarve të gjinisë femërore dhe 18% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore. Ndërkohë, një (4%) e diplomuar e gjinisë femërore merr 65,001 – 80,000 lekë dhe një tjetër (4%) merr më shumë se 80,001 lekë. Nga ana tjetër, 22% (N=10) e të diplomuarve meshkuj marrin 65,001 – 80,000 lekë dhe 33% (N=15) merr më shumë se 80,001 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=45); F (N=24).

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të pestë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht 80% e të diplomuarve (2016-2022) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 8% e të diplomuarve (2016-2021) punojnë me kohë të pjesshme dhe 12% me kohë të plotë sezonale.

Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=16); 2018 (N=14); 2019 (N=16); 2020 (N=40); 2021 (N=69); 2022 (N=66)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2022) vërehet se 42% e të diplomuarve punojnë në kompani me 10-49 punonjës, 27% në kompani me 5-9 punonjës, 9% në kompani me 1-4 punonjës dhe 21% punojnë në kompani me mbi 50 punonjës.

Mesatarisht, nga viti 2016-2021, 25% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me më shumë se 50 punonjës, 20% në kompani me 10-49 punonjës, 28% në kompani me 5-9 punonjës dhe 27% në kompani me 1-4 punonjës.


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=16); 2018 (N=14); 2019 (N=16); 2020 (N=40); 2021 (N=69); 2022 (N=66)

Në vitin 2022, 68% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 45% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 23% me afat të caktuar. Ndërkohë, 27% nuk kanë një kontratë pune. Numri i këtyre të fundit mbetet i lartë. Megjithatë për vitin 2022 vërehet një përmirësim me 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 ku 28% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin.


Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=16); 2018 (N=14); 2019 (N=16); 2020 (N=40); 2021 (N=69); 2022 (N=66)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të shtatë brezave, 77% e të diplomuave të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Ndërkohë, mesatarisht 12% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 10% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=16); 2018 (N=13); 2019 (N=16); 2020 (N=40); 2021 (N=69); 2022 (N=66)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Këtu vërehet një ulje me 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (80%). Ndërkohë, 8% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen “shumë të pasigurt”. Mesatarisht, nga viti 2016 në vitin 2021, 5% e të diplomuarve kanë pohuar se ndjeheshin “shumë të pasigurt”. Pra, vërehet një rritje e pasigurisë me 3 pikë përqindje.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 77% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 6% u shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Shumë i/e pasigurt</i>	7%	0%	0%	13%	5%	3%	8%
<i>I/e pasigurt</i>	0%	6%	0%	19%	3%	4%	3%
<i>Neutral</i>	0%	19%	15%	0%	20%	13%	17%
<i>I/e sigurt</i>	79%	69%	77%	63%	23%	64%	44%
<i>Shumë i/e sigurt</i>	14%	6%	8%	6%	50%	16%	29%
<i>Shumë i/e pakënaqur</i>	7%	13%	8%	13%	3%	4%	6%
<i>I/e pakënaqur</i>	0%	6%	8%	6%	5%	3%	6%
<i>Neutral</i>	0%	25%	8%	13%	15%	16%	11%
<i>I/e kënaqur</i>	57%	38%	62%	50%	43%	61%	48%
<i>Shumë i/e kënaqur</i>	36%	19%	15%	19%	35%	16%	29%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=16); 2018 (N=13); 2019 (N=16); 2020 (N=40); 2021 (N=69); 2022 (N=66)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 51% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur ta gjejnë punën para diplomimit, 8% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 13% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 8% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit dhe 11% kanë gjetur punë 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, 8% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=72

Në një vështrim krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 43% e të diplomuarve 2016-2021 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një rritje me 8 pikë përqindje për vitin 2022, ku 51% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 16% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2016-2021). Në këtë kategori kemi një ndryshim me 8 pikë përqindje për vitin 2022 ku 8% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit. Ndryshim me 4 pikë përqindje kemi në kategorinë e atyre që e gjejnë punën 1 – 3 muaj pas diplomimit (17% në 2022, 13% mesatarja e viteve 2016-2021).

Ndërkohë, është ulur me 2 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 3 - 6 muaj pas diplomimit (8% në 2022, përkundrejt 10% (mesatarja) në vitet 2016-2021) si dhe është rritur me 6 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 6 – 9 muaj pas diplomimit (11% në 2022, 5% mesatarja e viteve 2016-2021). Nuk ka ndryshim në numrin e atyre që gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit (8% në 2022, 8% mesatarja e viteve 2016-2021).

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	31%	38%	38%	33%	61%	55%	51%
1 muaj pas diplomimit	44%	4%	13%	19%	8%	10%	8%
1 - 3 muaj pas diplomimit	6%	27%	31%	14%	18%	5%	13%
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	15%	6%	19%	6%	13%	8%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	8%	0%	10%	2%	9%	11%
9 - 12 muaj pas diplomimit	13%	8%	13%	5%	4%	8%	8%
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	6%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=16); 2017 (N=26); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=49); 2021 (N=77); 2022 (N=72)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të shtatë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht, 73% e të diplomuarve gjatë viteve

2016-2021, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2022 kjo përqindje është 57%, duke shënuar një ulje me 16 pikë përqindje.

Mënyrë tjetër për gjetjen e punës së parë është praktika profesionale në biznes. Mesatarisht, 8% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2021 e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes. Vërehet një rritje me 10 pikë përqindje në këtë kategori për vitin 2022, ku 18% e të diplomuarve janë shprehur se e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes.

Mënyra e tretë mbizotëruese është nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta. Mesatarisht, gjatë viteve 2016-2021, 7% e të diplomuarve e kanë gjetur punën e parë falë njoftimeve për punë. Këtu vërehet një rritje me 11 pikë përqindje për vitin 2022, ku 18% e të diplomuarve e gjetën punën falë njoftimeve.

Për më tepër, 9% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2021 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësit. Ndërkohë, vetëm 4% e të diplomuarve në vitin 2022 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësit, duke shënuar një ulje me 5 pikë përqindje.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	0%	8%	6%	14%	8%	5%	18%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	81%	69%	88%	71%	65%	66%	57%
Nga praktika profesionale në biznes	13%	0%	0%	5%	12%	17%	18%
Duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësin tim	6%	19%	6%	10%	10%	5%	4%
Nga mësuesit	0%	0%	0%	0%	0%	3%	1%
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	0%	0%	2%	1%	0%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	0%	0%	2%	1%	1%
Tjetër	0%	4%	0%	0%	0%	1%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=16); 2017 (N=26); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=49); 2021 (N=77); 2022 (N=72)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 49% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (rritje me 16 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (33%)); 43% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (ulje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (38%)). Gjithashtu, vërehet se mbetet i lartë numri i atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar. Në vitin 2022, 23% (N=16) e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në këtë aspekt kemi një rritje me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (15%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
--	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------


Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	10%	36%	38%	52%	25%	38%	49%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	20%	58%	38%	29%	36%	47%	43%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	45%	9%	13%	14%	16%	24%	23%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	10%	0%	13%	19%	32%	14%	23%
Tjetër	20%	6%	6%	0%	0%	4%	1%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017; (N=33); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=56); 2021 (N=76); 2022 (N=69)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2022, vetëm 11% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2016-2021 ka qenë 4%. Në këtë aspekt kemi një rritje me 7 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 21% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2022 shprehen se janë student/kursant. Këtu vërehet një ulje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 22%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=64); 2017 (N=66); 2018 (N=46); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 82% (28 nga 34 të gjurmuar) dhe 18% (6 nga 34), studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=17); 2017 (N=13); 2018 (N=17); 2019 (N=17); 2020 (N=26); 2021 (N=18); 2022 (N=34)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 62% (N=21) studiojnë në institucione publike dhe 38% (N=13) në ato private. Në dy vitet e mëparshme (2020-2021), mesatarja ka qenë 59% në institucione publike dhe 41% në ato private. Pra vërehet një ndryshim me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2020-2022 lidhur me llojin e institucionit ku të diplomuarit vijojnë studimet e mëtejshme, me një favorizim të institucioneve publike për vitin 2022.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=26); 2021 (N=18); 2022 (N=34)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 68% (23 nga 34) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrajt 32% (11 nga 34) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2022 mesatarisht 55% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrajt 45% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=26); 2021 (N=18); 2022 (N=34)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 62% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (43% mesatarja e vitetve 2016-2021), 21% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (13% mesatarja e vitetve 2016-2021) dhe 15% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (42% mesatarja e viteve 2016-2021). Ndërkohë, një i/e diplomuar (3%), ndjek kualifikime të mëtejshme pasi nuk po gjente dot punë.

Tabela 9: Arsyes kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	47%	38%	47%	40%	50%	33%	62%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	47%	46%	41%	47%	23%	50%	15%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	6%	8%	6%	13%	27%	17%	21%
Nuk po gjeja dot punë	0%	8%	6%	0%	0%	0%	3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=17); 2017 (N=13); 2018 (N=17); 2019 (N=15); 2020 (N=26); 2021 (N=18); 2022 (N=34)

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 është 15% (N=16), me një ulje me 19 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (34%). Sikurse vihet re nga figura 25, viti 2022 shënon nivelin më të ulët të papunësisë ndër vite.


Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=64); 2017 (N=66); 2018 (N=46); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, gjysma e të diplomuarve të papunë të vitit 2022 u përgjigjën që po kërkonin punë. E shprehur në numër absolut, 8 nga 16 të diplomuarit e papunë janë në kërkim të një pune. Mesatarisht, në vitet 2020 dhe 2021, 60% e të diplomuarve të papunë janë shprehur se ishin në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=27); 2021 (N=28); 2022 (N=16)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mungesa e ofertave për punë që lidhen me arsimimin (38% në 2022, 15% mesatarja e viteve 2016-2021), mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur punë (13% në 2022, 17% mesatarja e viteve 2016-2021), si dhe mungesa e eksperiencës në punë (13% në 2022, 14% mesatarja e viteve 2016-2021).

Ndërkohë, në vitin 2022, një (13%) i/e diplomuar pohon se arsyeja e papunësisë është sepse njohuritë që ka marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës, me një rritje me 11 pikë përqindje nga

mesatarja e viteve 2016-2021 (2%). Për më tepër, një i/e diplomuar (13%) shprehet se është i/e angazhuar në punë familjare ndaj është i/e papunë.


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	12%	17%	27%	4%	18%	6%	13%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	4%	7%	0%	0%	0%	0%	13%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	4%	14%	18%	13%	12%	31%	38%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	31%	10%	18%	8%	18%	19%	13%
Nuk ka punë në qarkun tim	27%	31%	18%	21%	35%	6%	13%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	14%	18%	8%	0%	0%	13%
Tjetër	15%	7%	0%	13%	12%	38%	0%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	8%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-19	0%	0%	0%	33%	0%	0%	0%
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	6%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=26); 2017 (N=29); 2018 (N=11); 2019 (N=24); 2020 (N=17); 2021 (N=16); 2022 (N=8)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), për vitin 2022 ka një përqindje të barabartë të të diplomuarve që pohojnë se kërkojnë punë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta (38%) dhe nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve (38%). Në dy vitet e fundit, përkatësisht 13% e të diplomuarve në 2022 dhe 6% e të diplomuarve në 2021 pohojnë se kërkojnë punë nëpërmjet Zyrës së Punës. Ndërkohë, përkatësisht 2 (12%) të diplomuar në 2021, 3 (19%) të diplomuar në 2021 dhe 2 (25%) të diplomuar në 2022 gjetën punë nëpërmjet shkollës.

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumata e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=17); 2021 (N=16); 2022 (N=8)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), 3 nga 8 të diplomuarit e papunë (38%) në vitin 2022 u shprehën se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Në vitin 2021, 5 nga 12 të diplomuarit e papunë ose 42% nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Ndërkohë, 2 (25%) të diplomuar pohuan se kujdeseshin për fëmijët/familjen. Në vitin 2020, 2 nga 10 të diplomuarit e papunë u shprehën se kujdeseshin për fëmijët/familjen, ndërsa në vitin 2021, 1 nga 12 të diplomuarit e papunë kujdeseshin për familjen. Ndërkohë, 1 nga 8 të diplomuarit e papunë (13%) në vitin 2022, është shprehur se ka në plan të largohet nga vendi. Në vitin 2020, 3 nga 10 të diplomuarit të papunë dhe në vitin 2021, 2 nga 12 të diplomuarit e papunë kishin në plan të largoheshin nga vendi. Për më tepër, 1 nga 8 të diplomuarit e papunë pohon se pret të fillojë punë së shpejti. Një vit më parë (2021), 2 nga 12 të diplomuarit e papunë u shprehën se po prisnin të fillonin punë së shpejti. Gjithashtu, nga të diplomuarit e papunë në vitin 2022, 1 (një) i diplomuar është shprehur se nuk ka besim se do gjej një punë.


Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	10%	17%	13%
Nuk kam besim se do gjej një punë	0%	0%	13%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	30%	42%	38%
Kam në plan të largohem nga vendi	30%	17%	13%
Kujdesem për fëmijët/familjen	20%	8%	25%
Jam me aftësi ndryshe	10%	0%	0%
Tjetër	0%	17%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumata e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=10); 2021 (N=12); 2022 (N=8)

Sikurse e tregon edhe figura 28, niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është rritur në mënyrë të vazhduar nga viti 2018. Mesatarisht, nga viti 2016 deri në vitin 2022, 26% e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herët në marrëdhënie pune.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=26); 2017 (N=29); 2018 (N=11); 2019 (N=24); 2020 (N=27); 2021 (N=28); 2022 (N=16)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit, është tek nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset (61%), me një rritje me 16 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2021 (45%), praktika në biznes (60%), me një rritje me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (50%), si dhe tek bashkëpunimi me zyrat e punësimit (60%), me një rritje me 21 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 (39%). Për më tepër, kërkohet të përmirësohet këshillimi i karrierës (58%), metodat e mësimdhënies (52%), infrastruktura (49%), si dhe praktika në shkollë (48%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	35%	39%	19%	19%	30%	52%	49%
Kurrikula			13%	14%	38%	44%	42%
Tekstet dhe materialet	30%	30%	13%	23%	49%	59%	41%
Metodat e mësimdhënies	25%	27%	13%	19%	44%	63%	52%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	19%	14%	48%	63%	49%	19%	14%
Praktika në shkollë	40%	39%	38%	36%	47%	58%	48%
Praktika në biznes	35%	61%	56%	29%	54%	63%	60%
Këshillimi i karrierës	20%	33%	38%	24%	47%	55%	58%
Bashkëpunimi me bizneset	40%		50%	24%	53%	57%	61%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	35%	36%	31%	24%	53%	55%	60%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=33); 2018 (N=16); 2019 (N=21); 2020 (N=96); 2021 (N=61); 2022 (N=69)

Nëse do të kishin mundësi, 79% e të diplomuarve në vitin 2022 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 86% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 84% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 85% të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=44); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2022, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 88% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 72% e të diplomuarve në TIK dhe 90% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të zgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 95% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 79% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 69% e të diplomuarve TIK dhe 80% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Sikurse vërehet nga tabela, të diplomuarit në Ekonomi-Biznes tregojnë nivelin më të lartë të përzgjedhjes së të njëjtës degë dhe shkollë krahasuar me drejtimet e tjera për vitin 2022.

Mesatarisht, nga viti 2018-2021, 82% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 79% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, mesatarisht për vitet 2020 dhe 2021, 91% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 89% të njëjtën shkollë. Të diplomuarit në TIK (mesatarisht 2018-2021) do e përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 87% dhe të njëjtën shkollë në masën 86%.

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)


		Administrim zyre	Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm	TIK	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore
		Të diplomuar në 2018	Degë	78%	88%	
	Shkollë	100%	92%		82%	
Të diplomuar në 2019	Degë		86%		94%	
	Shkollë		86%		100%	
Të diplomuar në 2020	Degë		73%	91%	80%	

	Shkollë		62%	86%	74%	
Të diplomuar në 2021	Degë		82%	90%	91%	67%
	Shkollë		76%	93%	88%	56%
Të diplomuar në 2022	Degë		95%	79%	69%	80%
	Shkollë		100%	88%	72%	90%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{AZ}=9; N_{EB}=24; N_{TIK}=11; **Baza 2019:** N_{EB}=37; N_{TIK}=18; **Baza 2020:** N_{EB}=26; N_{HT}=35; N_{TIK}=35; **Baza 2021:** N_{EB}=33; N_{HT}=40; N_{TIK}=34; N_{SHSSH}=9; **Baza 2022:** N_{EB}=20; N_{HT}=48; N_{TIK}=29; N_{SHSSH}=10

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, për vitin 2022, 79% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 80% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 83% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 87% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë.


Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M: 2018** (N=18); **2019** (N=23); **2020** (N=65); **2021** (N=65); **2022** (N=53); **Baza F: 2018** (N=26); **2019** (N=32); **2020** (N=31); **2021** (N=51); **2022** (N=54)

Ndërkohë, përzgjedhja e së njëjtës shkollë e disagreguar sipas gjinisë jepet në figurën 31. Për vitin 2022, 81% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 91% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 88% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 82% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=18); 2019 (N=23); 2020 (N=65); 2021 (N=65); 2022 (N=53); **Baza F:** 2018 (N=26); 2019 (N=32); 2020 (N=31); 2021 (N=51); 2022 (N=54)

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtjeshëm (shiko tabelën 14), 38% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një ulje më 12 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (26%). Ndërkohë, 36% e të diplomuarve pohojnë se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 11 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 (25%).

Për më tepër, 23% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë të punësuar, me një rritje me 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021 (30%). Ndërkohë, për vitin 2022, 8% e të diplomuarve planifikojnë të emigrojnë jashtë vendit në dy vitet e ardhshme, me një ulje me 13 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2021 (21%). Dëshira për migrim të brendshëm vijon të mbetet e ulët (1%).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	37%	26%	27%	42%	16%	30%	23%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	2%	12%	50%	25%	29%	35%	38%
Të kem filluar biznesin tim	21%	18%	20%	18%	45%	28%	36%
Të kem ndjekur studime të mëtjeshme	14%	27%	23%	22%	19%	16%	13%
Të kem emigruar jashtë vendit	8%	29%	25%	25%	23%	16%	8%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	37%	2%	2%	2%	0%	1%	1%
Tjetër	21%	6%	5%	0%	6%	4%	3%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shumta e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=63); 2017 (N=66); 2018 (N=44); 2019 (N=55); 2020 (N=96); 2021 (N=116); 2022 (N=107)

4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës “Kolin Gjoka” duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 97% e të diplomuarve të vitit 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 107 të anketuarish, 50% ishin të punësuar, 3% ishin të vetëpunësuar, 21% ishin student/kursant, 11% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 15% e të diplomuarve një vit pas diplomimit.
- 77% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 69% e të diplomuarve në TIK, 45% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 30% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 40% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 40% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 17% e të diplomuarve në TIK dhe 10% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë student/kursant.
- 57% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 43% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2016 deri në 2021, mesatarisht 37% e të diplomuarve pohuan se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 63% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, të disagreguara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 46% e të diplomuarve të gjinisë femërore dhe 54% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore punojnë në profesion.
- Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 52%. Vërehet një rritje me 11 pikë përqindje në karhasim me mesataren e viteve 2016-2021.
- Për vitin 2022, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 3% më pak se paga minimale, 19% paga minimale – 35,000 lekë, 19% marrin 35,001 – 50,000 lekë, 20% marrin 50,001 – 65,000 lekë, 16% marrin 65,001 – 80,000 lekë dhe 23% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve: 10% e të diplomuarve në TIK marrin më pak se paga minimale. Ndërkohë, 67% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 19% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 15% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë minimale – 35,000 lekë. Për më tepër, 33% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 25% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm marrin një pagë midis 35,001 – 50,000 lekë. Ndërkohë, 20% e të diplomuarve në TIK dhe përkatësisht nga 20% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe Hoteleri-Turizëm marrin një pagë mes 50,001 – 65,000 lekë. Një pagë 65,001 – 80,000 lekë e marrin 22% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 10% e të diplomuarve në TIK. Më shumë se 80,001 lekë e marrin 33% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes 24% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 20% e të diplomuarve në TIK.
- 51% e të diplomuarve janë punësuar para se të diplomohen, kjo shënon një rritje me 8 pikë përqindje në raport me mesataren 2016-2021 ku 43% e të diplomuarve gjenin punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 8% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 13% një deri në tre muaj pas diplomimit, 8% tre deri në gjashtë muaj pas diplomimit, 11% gjashtë deri në nëntë muaj pas diplomimit. Vetëm 8% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 73% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 77% “të kënaqur ose shumë të kënaqur”. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 15%. Në numër absolut kjo shkon në 16 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 8 prej tyre (50%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatesisht, bashkëpunimi me bizneset (61%), praktika në biznes (60%), bashkëpunimi me zyrat e punësimi (60%), këshillimi i karrierës (58%), metodat e mësimdhënies (52%) dhe infrastruktura (49%) kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme, 38% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit dhe 36% të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 6 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (32%).